

E gjithë harresa nuk është demencë

FLETË ME TË DHËNA NGA QENDRA SUEDEZE E DEMENCËS

All glömska är inte demens • faktablad på albanska

Kur funksionet e trurit ligështohen

Gati gjithçka që ne bëjmë janë të varura nga funksionet lidhen me të menduarit. Kur ne kërkojmë në memorien, mësojmë gjëra të reja, ose kërkojmë artikuj në shtoret, janë të ndryshme, *funksione kognitive* aktiv. Ato kanë rëndësi të madhe, për mundësitë tona, për të jetuar një jetë të pavarur.

Kur një apo më shumë funksione kognitive funksionojnë, dukshëm më keq se më përpara, bëhet fjalë për *ligështim kognitiv*. Mund të shprehet, si p.sh. harresë, problem për të gjetur drejtë, ose të planifikosh dhe të kryesh, normalisht aktivitete të thjeshta.

Është me rëndësi të shqyrtohet ligështimi kognitiv, që të mund trajtohet në mënyrën më të mirë. Por jo gjithmonë mjekësia mundet të gjej një shpjegim të qartë të simptomës, sidomos kur ato janë të lehta.

Ligështimi kognitiv, ndahet zakonisht në tre nëngrupe: hutim akut, zvogëlim i lehtë i funksionit kognitiv dhe sëmundja kognitive.

Hutimi akut, shpesh zhduket

Kur simptomat kognitive zhvillohen shpejtë, gjatë një kohe të shkurt, bëhet shpesh fjalë për hutimin akut ose çrregullim siç quhet në gjuhën profesionale. Tek personat e moshuar, shpesh e ka shkakun nga ngarkesa fizike e psikike, pas një operacioni ose për shkak të dhembjes. Hutimi akut mund të varet edhe nga kapsllëku, infeksionet ose nga pasojat anësore të ilaçeve.

Hutimi akut mund të trajtohet dhe simptomat zakonisht zhduken, nënkuptuar që gjendja të shqyrtohet dhe t'ia dilet në krye shkaqeve.

MCI shkurtesë për simptomën e lehtë

Shumë njerëz kërkojnë ndihmë nga mjekësia për shqetësimin, se ata nuk funksionojnë si më parë. Simptomat mund të jenë të paqarta dhe të dobëta, por personat megjithatë ndjejnë qartë, se kanë më të vështirë të koncentrohen dhe t'ia vendosë gjërat në memorie ose merr një kohë më të gjatë të kryej aktivitete të ndryshme.

Këto janë shenja tipike kur bëhet fjalë për një zvogëlim të lehtë të funksionit kognitiv ose MCI (*Mild cognitive impairment*) që është shpesh

shkurtesa e përdorur e anglishtes. Në rast të MCI, zvogëlimi kognitiv mund të tregohet në testet neuro-psikologjike. Sistemet mund të ndikojnë në jetën sociale ose në punën profesionale, por jo edhe në shkallë të lartë si është në rastin e demencës.



Shumë shkaqe të mundshme

MCI mund të ketë shumë shkaqe. Depresioni jo i trajtuar, tromboza dhe pasojat anësore nga ilaçet, janë vetëm disa nga shembujt. Në disa raste, bëhet fjalë për shenjat e hershme të një sëmundje kognitive, p.sh. sëmundja Alzheimer ose demencë vaskulare. Atëherë simptoma bëhet më e fortë dhe më pas edhe më të shumta. Por plakja do të thotë, se funksionet kognitive mund të keqësohen pakëz, pa u varur këto nga demenca. Në çfarë shkalle bëhet, ndryshon nga personi tek personi tjetër.

Shqetësimi, lodhja dhe dëshpërimi janë të zakonshme në rast të MCI dhe mund të forcojnë simptomat kognitive. Ngarkesa e madhe nga puna dhe nga stresi bën që njerëzit aktiv të profesioneve të ndryshme, si dhe mosha mund të përjetojnë, se ata kanë probleme kognitive, pa mundur të tregohet në testet neuro-psikologjike.

Ndjekja është A dhe O

Trajtimi i MCI supozon, se shkakun që qëndron pas të jetë i njohur, diçka që nuk është gjithmonë ashtu. Megjithatë është e rëndësishme që mjekësia të ndjek rregullisht atë që është i përfshirë nga kjo, pavarësisht se a është i lexueshëm zvogëlimi i funksionit në situata të testit ose vetëm e ndien ashtu.

28 janar 2019 • Qendra suedeze e demencës ©

Më shumë fletë me të dhëna në gjuhë të ndryshme mund të printohen nga uebfaqja e Qendrës suedeze të demencës:
www.demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Qendra suedeze e demencës, Sveavägen 155, 113 46 Stockholm, 08 - 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se